





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL  
MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA



Nr.regj.24909/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Sevdije Gashin duke vendosur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje me nr;104/2012,të dt.01.02.2012, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sreten Trajan Ivanoviqit nga N.Bërda, për kundërvajtje nga neni 6.parg.1 dhe 2 i sanksionuar me nenin 16 parg.1 dhe 2. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhurtave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.**21.06.2012** merrë këtë,

#### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:**Sreten Trajan Ivanoviq e lindur me 16.09.1973 në Turniqevc,K.N.Bërdos,ku edhe tani jeton,,i martuar,babë i 3 femijve, i gjendjes së mesme ekonomike,kulifikimi shkollor magjister,Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës

#### Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Drejtor i Administratës së Përgjithëshme në Komunën e N.Bërdës,nuk e ka bërë deklarinimin e rregullt të pasurisë për vitin 2010 pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve,të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë.

Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 6 parag.1 dhe 2.i sanksionuar me nenin 16 parg.1 dhe 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik,me nr.03/L-151 andaj për këtë:

#### D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **800 (tetëqin )€**, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej **30 ditësh** duke ju llogaritur **15 €** në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 EURO**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobës bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

#### A r s y e t i m

**Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë**,me kërkesën nr.01-3206/11 të parashtruar gjykatës me datën 19.07.2011 për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur me lartë, për kundervajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komunale për Kundervajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kërkesës,e zvillon procedurën kundervajtse dhe të pandehurit e shpalli fajtor dhe e denoi me gjobë prej 800 eurosh,dhe në emer të paushallit gjyqësor në shumën prej 5 eurosh.

I pandehuri Sreten Ivanoviqi në aftain e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë,me arsyetim se aktvendimi nuk është nxierr në menyr të drejtë,e të të cilin ka shkelje ligjore.

03-2383/12/02  
fscg

2.

Gjykata e Lartë për Kundervaje me dt.01.02.2012, me Aktvendimin me nr:104/2012, e Abrogon Aktvendimin me nr.Regj:24909/11, lënden ja kthenë Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ku e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin e provave që i pandehuri i thekson në ankesë. Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJ.L.nr:104/2012, me dt.01.02.2012, gjyqtari kerkoj nga Agjencioni Antikorrupcion, që bënë plotësimin e kërkeses sipas udhëzimeve në aktvendimin e të Gjykatës së Lartë.

**Parashtruesi i kërkesës me datën 14.03.2012**, ju përgjigjë kërkesës së gjykatës dhe beri plotësimin e kërkeses, me nr.01-104/2012 duke theksuar se Agjencioni në muajn Mars të vitit 2011e ka publikuar listen e zyrtarve të lartë që kanë për obligim deklarimin e pasurisë sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik me Nr.03/L-151, e ku në mesin e tyre ka qenë edhe Sreten Ivanoviqi, në atë kohë Drejtor i Administratës në Komunën e N.Berdos, i cili në këtë pozitë ka qendruar deri më dt.11.03.2011, ndersa betimin si Deputet në Kuvendin e Kosovës e bënë me dt.21.02.2011, e ku të dyja këto data përkojnë me afatin nga neni 6 parag.2 i ligjit në fjalë. Edhe pse i njeti ka ndërrue pozitën edhe si Drejtor edhe si Deputet ka qenë i obliguar ta bënë deklarimin e pasurisë në afatin ligjor. Agjencioni ka inicur procedurën kundervajtëse për mosdeklarim të rregullt vjetor të pasurisë.

Gjykata me kujdes shqyrtoj vrejttjet e dhenura nga Gjykata e Lartë sipas Aktvendimit me nr:104/12, të dt.01.02.2012, pastaj ndërmorri të gjitha veprimet procedurale, thirri parshtruesin e kërkesës përë iniciimin e procedureës që me plotësim kërkesë të sqarohet lidhur me vrejttjet që janë dhen nga Gjykata e Lartë, pastaj edhe një herë me një kujdes të madh shqyrtoj kërkesën, plotësim kërkesen, deklaratën e të pandehurit deshmitarve, dhe provat të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe erdhi në përfundim se i pandehuri Sreten Ivanoviqi ka kryer kundervajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundervajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshën e kundervajtjes, si dhe rrethanat tjera konform nenit 7 të LMK-së

Duke i marrë prasysh të gjitha këto u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Konform nenit 109.al.2 e LMK-së, caktohen shpenzimet e procedureës

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundervajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË.**

Gjyqtari  
Murat Paçarada

